Bashkia Lushnje

SHPALLJE
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË KATEGORISË SË LARTË DREJTUESE NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Lloji i diplomës " Shkenca Juridike/Ekonomik/Inxhinier "niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe të Kreut III, dhe Kreut VIII, të Vendimit Nr. 118, datë 5.3.2014, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së",i ndryshuar , Bashkia Lushnje shpall procedurat për plotësimin e vëndit të lirë në kadegorine e lartë drejturese për pozicionin:

Sekretar i Përgjithshëm

(Kategoria e pages I- 4)

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e ngritjes në detyrë!
Në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës se pranimit në shërbimin civil.

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 16.06.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

1. Sekretari i Përgjithshëm, përgjigjet para Kryetarit të Bashkisë për dhënien e këshillave lidhur me objektivat dhe përparësitë e njësisë së qeverisjes vendore, si dhe për sigurimin e funksioneve menaxhuese të bashkisë në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të Bashkisë.
2. Formulon politikat e institucionit, këshillon punonjësit dhe merr masa për zbatimin politikave;
3. Merr masa për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të institucionit dhe përgjigjet përpara Kryetarit të Bashkisë në përputhje me legjislacionin.
4. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve, lidhur me politikat, duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve të konstatuara.
5. Bazuar në ligj, kryen detyra të tjera të ngarkuara me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

I-Ngritje në detyrë

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë së mesme dhe të lartë drejtuese në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR NGRITJE NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, në kategorinë e mesme dhe të lartë drejtuese;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv “Mirë” apo “Shumë mire” ;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor apo Profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në degën “Shkenca Juridike/Ekonomik/Inxhinier”, si edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë,.”(*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura, nga këto jo më pak se 3 (tre) vjet në pozicion drejtues.
c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
e) Njohuri të gjera lidhur me fushën e përgjegjësisë së institucionit, aftësi të drejtimi stradegjik, kuptim të gjerë të kopmetencave ndërsektoriale;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të (*Bashkia Lushnje)* ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë displinore në fuqi.
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.06.2025

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 18.06.2025, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Lushnje, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "*Agjencia Kombëtare e Punësimit Dhe Aftësive*" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013,*"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
b. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003,*"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
c. Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*";
d. Njohuritë mbi Ligjin Nr.90/2012" *Për Organizimin dhe Funksionimin e Administrates Shteterore*";
e. Njohuritë mbi "*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar;
f. Njohuritë mbi „*Kodin e Punes*", i ndryshuar;
g. Njohuritë mbi "*Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*;
h. Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 "*Për të drejtën e Informimit*";
i. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008,"*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
j. Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar;
k. Njohuritë mbi Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administrates shtetërore në Republikën e Shqipërisë";*

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 15 pikë.

Testimi me shkrim; Totali i pikeve do të jetë 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 25 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*",të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lushnje do të shpallë fituesin në portalin "*Agjencia Kombëtare e Punësimit Dhe Aftësive*". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së ngritjes ne detyre, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil .

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nepunesit civil", i ndryshuar.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

f) Të jetë shtetas shqiptar;
g) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
h) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
i) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
j) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
k) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor apo Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në degën "Shkenca Juridike/Ekonomik/Inxhinier", si edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë,."(*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të*

jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 10 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura
c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.06.2025 në Bashkine Lushnje

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj proçedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20.06.2025,njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkia Lushnje, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin "*Agjencia Kombëtare e*

Punësimit Dhe Aftësive" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
b. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
c. Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*";
d. Njohuritë mbi Ligjin Nr.90/2012" *Për Organizimin dhe Funksionimin e Administrates Shteterore*";
e. Njohuritë mbi "*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar;
f. Njohuritë mbi „*Kodin e Punes*", i ndryshuar;
g. Njohuritë mbi "*Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*;
h. Njohuritë mbi Ligjin Nr.119/2014 "*Për të drejtën e Informimit*";
i. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008,"*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
j. Njohuritë mbi Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", i ndryshuar;
k. Njohuritë mbi Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administrates shtetërore në Republikën e Shqipërisë";*

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lushnje do të shpallë fituesin në portalin "*Agjencia Kombëtare e Punësimit Dhe Aftësive*". Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

Bashkia Lushnje